



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:021155

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876707

KPPP.nr.1055/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “PREMIJA” D.O.O., me seli në Novi Pazar, rr. “Mur bb” 36300, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Atdhe Dika, kundër debitorit “Runis” SH.P.K., me NUI: 810848012, me seli në rr. “Rexhep Krasniqi”, Lagjja Emshir, Nr. 1, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.29/2019 të datës 13.03.2019, nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Runis” SH.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.29/2019, i datës 13.03.2019, i Përmbartuesit Privat Arben Gashi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “PREMIJA” D.O.O., me datë 13.03.2019, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.29/2019, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 392 të datës 16.05.2017 dhe CMR me numër 000854; Faturës Nr. 437 të datës 24.05.2018 dhe CMR me numër 001451 dhe Faturës Nr. 929 të datës 16.10.2018 dhe CMR me numër 1167; me të cilin ka detyruar debitorin që menjëherë t’ia paguaj kreditorit shumën prej 6,300.00 €, me kamatëvonesë ligjore prej 15.30%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të kundërtën nëse debitori nuk e përmbush detyrimin në afatin e caktuar paraprak, të caktohet përmbartimi i dhunshëm me bllokimin e llogarive bankare të debitorit, si dhe me shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se i ka përfunduar të gjitha obligimet që ka ndaj kreditorit, përveç Faturës Nr. 929 të datës 10.10.2018 që i referohen shërbimit të kryer lidhur me transportin e kërkuar të mallit. Më tutje ka shtuar se kreditori ka pasur edhe pretendime të mëparshme ndaj debitorit lidhur me një borxh të paqenë për shërbime që i ka ofruar, por që borxhi i tillë është kontestuar në vazhdimësi nga debitori, gojarisht dhe me shkrim, për shkak se kreditori ka vazhduar të dërgojë fatura për shërbimin i cili nuk është ofruar. I ka propozuar gjykatës që të anuloi urdhrin përmbartimor, si dhe të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë procedurë.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka deklaruar se debitori nuk e kundërshton raportin e vet juridik me kreditorin dhe as pranimin e faturave dhe se i njëjti ka kundërshtuar pjesërisht dhe atë për Faturën Nr. 392 të datës 16.05.2017 dhe Faturën Nr. 437 të datës 24.05.2018. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.709/19 të datës 27.09.2021, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.29/2019 të datës 13.03.2019 të përmbartuesit privat Arben Gashi, sa i përket kamatëvonesës në lartësi prej 15%, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit sa i përket detyrimit në shumën prej 2,000.00 € me kamatëvonesë prej 8% dhe ka detyruar debitorin që t'ia paguaj të autorizuarit të kreditorit shpenzimet e lejimit të përmbartimit në shumën prej 70.80 €, si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumën prej 156.00 €.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1225/22 të datës 25.04.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.709/19 të datës 27.09.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm dhe lëndën i ka kthyer Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe vërejtjeve

të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr. 392 e datës 16.05.2017 dhe CMR me numër 000854; Fatura Nr. 437 e datës 24.05.2018 dhe CMR me numër 001451 dhe Fatura Nr. 929 e datës 16.10.2018 dhe CMR me numër 1167, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori pasi që të njëjtat nuk janë nënshkruar e as vulosur dhe si të tilla nuk janë të përshatshme për përmbartim.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si e tillë të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe CMR-të, si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga debitori, mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport me ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturën mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia

e detyrimit monetar që buron nga fatura. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1055/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.